

VENDIM
Nr.384, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare të familjeve të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, llogariten në shumën 65 500 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano